



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:192385

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04963756

PKR.nr.189/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.A, nga F., me banim në rrugën “B. dhe G. S.” pn, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.259/22, të datës 27.09.2022, i akuzuar për vepër penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, pas seancës së shqyrtimit fillestar të datës 22.11.2023 të mbajtur në prezencën e prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit M.A si dhe mbrojtësit të tij avokatit M.I., nga Peja, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa, me datë 23.11.2023 përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.A, i lindur me datë ..., në F., ku edhe jeton në rrugën “B. dhe G. S.” pn, i biri H. dhe nënës F., e gjinisë M., i pa martuar, me profesion automekanik, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i njohur sipas numër personal, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 19.08.2022 rreth orës 15:30min, në D., Komuna I.dhe atë brenda Qendrës Korrektuese të D.s, pa autorizim, shpërndan substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë dhe atë narkotikun e llojit *Mariuhanë* me sasi prej 0.7gram, në atë mënyrë që, i pandehuri M.pasi siguron narkotikun e lartcekur në Qendrën Korrektuese të D.s, të njëjtën me datën dhe kohën e lartcekur fillimisht e mbështjell me një letër të bardhë dhe najlon të zi, e fut në një pako të cigareve “R.” dhe më pas në pavijonin 1, në sallën e takimeve takohet me vëllain e tij G.A i cili po ashtu gjendet në vuajtje të dënimit në këtë qendër, të cilit paraprakisht i’a jep dy pako cigare dhe një qese me rroba, e më pas edhe narkotikun e lartcekur me pakon e cigareve “R.”.

- me çka ka kryer veprën penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, neni 267 par.2 dhe neni 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së si dhe nenet 358, 359, 360, 364 të KPPRK-së, të pandehurin M.A e gjykon me:

DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej **dy (2) vite** të cilin dënim me burg, i pandehuri do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe

DËNIM ME GJOBË në shumë prej **dyqind (200) euro** e të cilin dënim me gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e po qe se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg ku një ditë burgu do t'i llogarite në shumë prej njëzet (20) euro.

OBLIGOHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetepesë (25) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata nuk vendosi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike në peshë prej 0.7 gram sepse e njejta është konfiskuar me rastin PP/I.nr.241/22 kundër vëllait të tij, G.A., i cili po ashtu e ka pranuar fajësinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, kundër të pandehurit M.A, nga F., me banim në rrugën “B. dhe G. S.” pn., ka ngritur Aktakuzën, për shkak të veprës penale *blerja, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Me datë 22.11.2023, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare në prezencën e prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit M.A si dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatit M.I., nga Peja.

Pas leximit të Aktakuzës PP/I.nr.259/22, të datës 27.09.2022, nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mos pranimin e fajësisë. Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë me ç’rast i pandehurit M.A deklaroi se i kanë kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës dhe se e pranon fajësinë në baza vullnetare dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij.

Prokurori e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi ky pranim është i vullnetshëm dhe në harmoni me provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë së të pandehurit para gjykatës si dhe në procedurë paraprake ndërsa, si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimin të merret për bazë e kaluara e tij kriminale, njëherit substanca narkotike në peshë prej 0.7 gram nuk ka propozuar që të

konfiskohet sepse ajo është konfiskuar me rastin PP/I.nr.241/22 kundër vëllait të tij, G.A., i cili po ashtu e ka pranuar fajësinë.

Mbrojtësi i të pandehurit M.A, avokati M.I. deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ngase pranimi është bërë në mënyrë të plotë, të vullnetshme dhe pas konsultimeve me të si mbrojtës. Lidhur me dënimin ka deklaruar se pasi i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë në seancë të shqyrtimit fillestar e po ashtu edhe në fazat e mëhershme të procedurë penale, i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese si dhe keqardhjen që e shprehi i pandehuri për veprën e kryer penale dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 241 dhe 242 par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave por, gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit G.Adhënë në këtë Prokurori me datën 23.09.2022, Raporti pas bastisjes së datës. 19.08.2022, Raporti Informues i Policisë së Kosovës i datës 22.08.2022, Raporti i analizës se narkotikëve Nar Testi i datës 22.08.2022, Fotografitë e narkotikut dhe vendit të ngjarjes, Lista e dëshmitëve nga njësia e forenzikës e datës 25.08.2022, Shkresa e Qendrës Korrektuese të D.s e datës 22.08.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilën është shpallë fajtor.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese për të pandehurin gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në seancë fillestare dhe në fazën penale paraprake ndërkaq, nga rrethanat rënduese për të pandehurin gjykata gjeti të kaluarën e tij kriminale.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së e obligoi të pandehurin në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3 nënpar. 3.2 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata nuk vendosi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike në peshë prej 0.7 gram sepse e njehta është konfiskuar me rastin PP/I.nr.241/22 kundër vëllait të tij, G.A., i cili po ashtu e ka pranuar fajësinë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.189/22, me datë 23.11.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale
Tringa Zhuti

Kryetari i Trupit Gjykes
Sami Sharaxhiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.